



# Buletini Mjedisor

## DITA BOTËRORE E BIODIVERSITETIT NË SHQIPËRI



22 Maj është Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit, apo e Diversitetit Biologjik. Kjo ditë është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për të përkujtuar ditën 22 Maj 1992, kur u miratua teksti i Konventës së Biodiversitetit, në të cilën edhe Shqipëria është palë.

Qëllimi i kësaj dite është të sensibilizojë opininën për rëndësinë e biodiversitetit dhe për masat që duhet të merren për ruajtjen e tij.

Edhe Shqipëria i është bashkuar kësaj dite ndërkombëtare duke organizuar aktivitete të ndryshme sensibilizuese për vite me radhë në mbarë vendin. Shqipëria shquhet për një biodiversitet të larmishëm, mbi 36 % e territorit mbulohet nga pyjet të cilat përbëhen nga një shumëllojshmëri drurësh dhe shkurresh pyjore.

Në Shqipëri ndodhet rreth 30% e florës së Evropës, me rreth 3200 lloje bimësh, ndodhen rreth 780 lloje shtazore vertebrorë, 21 gëtarë dhe 17 lloje shpendësh të një rëndësie globale.

### FESTIVALI I FILMIT MJEDISOR

22 Maj ka marrë një kuptim të veçantë në Shqipëri në dy vitet e fundit, ku Ministria e Mjedisit me ndihmën e projektit të Bashkimit Europian, SELEA organizon festivalin e Filmit Mjedisor në Shqipëri. Në këtë vit, Festivali i filmit mjedisor përfshiu katër qytetet të Shqipërisë: Tiranën, Vlorën, Përmetin dhe Shkodrën. Gjatë ditëve të festivalit u shfaqën 19 filma të metrazhit të gjatë dhe 14 filma me metrazh të shkurtër. Risia e këtij vit ishte shfaqja e një numri më të madh filmash me tematikë nga mjedisi shqiptar krahasuar me vitin e shkuar.

Në fjalën përshëndetëse Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka theksoi se “ Mjedisi nuk ka kufi. Kjo duket edhe në pjesëmarrjen e autorëve nga vende të ndryshme të botës, të cilët sjellin një dimension më global mbi problematikat dhe qasjet mbi mjedisin dhe natyrën, e ndërthurur kjo me perspektivën shqiptare, parë nga autorët vendas. Një vlerë e shtuar e këtij edicioni të Festivalit të Filmit Mjedisor është shtrirja e shfaqjeve në qytete të tjera, përveç Tiranës, si Përmet, Vlorë dhe Shkodër, duke e bërë edhe më të gjerë impaktin që ky festival do të ketë në opinionin publik.

Gjithashtu Ministri Koka dha falenderim i veçantë për të gjithë organizatorët e këtij

festivali, të cilët me punën dhe kontributin e tyre po i shërbejnë më së miri mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.

Festivalin e përshëndeti dhe i ngarkuari me punë i përfaqësues së Bashkimit Europian në Shqipëri z. Clive Rumbold, i cili theksoi se “Festivali i Filmit mbi Mjedisin është një rast i shkëlqyer për të arritur një audiencë të gjerë dhe për të përmirësuar ndërgjegjësimin e publikut mbi çështjet mjedisore dhe zgjidhjen e tyre.

Festivali pati një shikueshmëri të lartë sidomos nga të rinj dhe aktivistë të Mjedisit.

### AKTIVITETE TË TJERA

Aktivitete në kuadër të Ditës Botërore të Diversitetit Biologjik u organizuan dhe në Qytetin e Orikut. Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me projektin për mbrojtjen e zonave detare të UNDP-së dhe bashkinë e Orikut zhvilluan një sërë aktivitete në kuder të kësaj dite. Aktiviteti me përfshirjen më të madhe të fëmijëve ishte java e konkursit me temë nga mjedisi e organizuar mes shkollave të qytetit dhe që u mbyll në 22 maj. Gjithashtu në mënyrë simbolike u bë dhe ujitja e pemëve në malin Llogara duke ju bashkuar nismës botërore “Vala e Gjellbër”, ku çdo individ i botës në të njëjtën orë duhet të ujisë një pemë.

#### NË KËTË NUMËR:

22 MAJ- DITA BOTËRORE E DIVERSITETIT

Fq. 1

LEJET MJEDISORE PRILL 2014

Fq. 2

INVENTARIZIMI I PËRDORUESVE TË BURIMEVE UJORE

Fq.3

PËR NË ADMINISTRATË PUBLIKE TË PËRGJEGJSHME DHE PROFESIONALE

Fq. 5

*“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit, dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.*

## LEJET MJEDISORE PRILL 2014

| NR | SUBJEKTI           | AKTIVITETI   | VENDODHJA                   | VENDIMI   |
|----|--------------------|--|-----------------------------|-----------|
| 1. | AGROIMPUL JAZXHI   | Riambalazhim produktesh për mbrojtjen e bimëve                       | Katund i ri, Kashar, Tiranë | Miratohet |
| 2. | EDLA               | Shfrytëzim minerali kromi  | Iballë, Pukë, Shkodër       | Miratohet |
| 3  | FYBEK              | Linjë për prodhimin e polisterolit                                   | Vorë, Tiranë                | Miratohet |
| 4  | HYSENI             | Fabrikë për prodhimin e birrës                                       | Elbasan                     | Refuzohet |
| 5  | IKERAL             | Fabrikë prodhim tulla qeramike                                       | Lukovë, Sarandë             | Miratohet |
| 6  | KASTRATI           | Prodhim/përpunim përzjerje biokarburantit                            | Katund i ri, Durrës         | Miratohet |
| 7  | KOKA               | Shfrytëzim minerali kromi  | Iballë, Pukë, Shkodër       | Refuzohet |
| 8  | PETROL GAZ ALBANIA | Impiant magazinim dhe tregtim gazi, GLN                              | Kashar, Tiranë              | Refuzohet |
| 9  | PROGRESI/L         | Shfrytëzim guri gëlqeror   | Librazhd Elbasan            | Miratohet |
| 10 | RIETTI             | Prodhim i materialeve hidraulike me materiale plastike               | Durrës                      | Miratohet |
| 11 | V.A.L.E RECYCLING  | III.2.B Grumbullim, transport, asgjësim (depozitim)I mbetjeve urbane | Fushë Kuqe, Laç, Lezhë.     | Miratohet |
| 12 | VELLEZERIT Tafa    | Linjë prodhimi inertesh betoni, magazinim i lëndës së parë           | Luz i Vogël, Kavajë         | Refuzohet |

## GEF VIJON INVESTIMET NË FUSHËN E MJEDISIT



GEF do asistojë Shqipërinë në katërvjeçarën e ardhshëm projektet në fushën e ndryshimeve klimatike, degradimit të tokës, biodiversitetit, pyjeve, ujërave dhe kimikateve.

Ky vendim që pjesë e vendimeve të marra në Asamblenë e 5-të të GEF - Fondi Mjedisor Global, të mbajtur në Meksikë ku mori pjesë dhe delegatët e Ministrisë së Mjedisit dhe Energjitikës të Shqipërisë, të kryesuar nga Ministri i Mjedisit dhe Energjitikës, Z. Koka u diskutua me Sekretarin e Meksikës për Mjedisin Z. Juan José Guerra Abud, dhe Presidentin e GEF, Znj. Naoko Ishii. Asambleja miratoi prioritetet dhe objektivat kryesore të GEF për katër vitet e ardhshme. Fushat kryesore të kësaj asistence lidhen me financimin e projektet në fushën e mjedisit, degradimit të tokës, ndryshimeve klimatike,

Shqipëria ka përfituar dhe do të vazhdojë të mbështetet nga GEF dhe për katër vitet e ardhshme. Ky financim do të jetë në formën projekteve për fushat e mësipërme dhe në total ato do të kapin shifrën e rreth 10 milionë dollarëve. Shqipëria do të jetë gjithashtu përfituese nga fondet shtesë të GEF edhe për një sërë projektsh rajonale dhe ndërkuftare që do të financohen këto katër vite sic janë ujërat ndërkuftare, ku prioritet do të ketë baseni i Drinit si dhe ujërat e deteve Adriatik dhe Jon.

## INVENTARIZIMI I PËRDORUESVE TË BURIMEVE UJORE



Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” dhe përputhshmërisë së tij të plotë me Direktivën Kuadër të Bashkimit Europian të Ujit, menaxhimi i burimeve ujore në vend ka hyrë në një fazë të re.

Ministria e Mjedisit është duke punuar për hartimin e akteve nënligjore për të mundësuar sa më parë zbatimin e plotë dhe të drejtë të Ligjit për Menaxhimin e Burimeve Ujore. Në këtë kontekst, në datën 21/05/2014, Ministria e Mjedisit prezantoi para përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit draft VKM-në për “Miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve

të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”.

Qëllimi i këtij akti, në radhë të parë, është inventarizimi i përdoruesve të ujit, krijimi i një regjistri kombëtar të të gjithë përdoruesve, të qëllimeve të përdorimit, dhe nëpërmjet kësaj fillimit të punës për një menaxhim real të ujit në Shqipëri.

Draft VKM-ja synon të përmirësojë procesin e legalizimit dhe inventarizimit të përdoruesve të ujit në të gjithë vendin, përmes miratimit të Formularëve tip të Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, duke detyruar të gjithë përdoruesit në vend të ofrojnë vetë-deklarim të përdorimit. Një ndër risitë që sjell ky projekt-VKM lidhet pikërisht me përcaktimin e detajuar të të gjitha kërkesave për përdorimin e burimit ujqor, sipas destinacionit të përdorimit dhe procedurat që duhen ndjekur nga momenti i paraqitjes së kërkesës për autorizim dhe leje dhe deri tek marrja e vendimit nga organet përgjegjëse.

Një tjetër risi që sjell vendimi është se në

fund të çdo formulari është parashikuar dhënia e informacionit për sa i përket shkarkimeve të ujërave të ndotur, të cilat do të jenë produkt i aktivitetit për të cilin subjekti do të pajiset me autorizim dhe leje të përdorimit të burimeve ujore.

Administrimi dhe inventarizimi i burimeve ujore dhe përdoruesve të tyre, qoftë edhe për efekt kërkimor, shkencor dhe statistikor, është detyrë e çdo shteti, pasi vetëm nëpërmjet kësaj rruge mund të flitet për menaxhim të ujit, që është një ndër sfidat më të mëdha globale. Ky projekt-akt pritet të ketë një ndikim pozitiv edhe në rregullimin e procesit të vaditjes, i cili në shumë raste në vendin tonë kryhet me ujë të pijshëm, dhe dëmton burimet ujore.

Gjatë punës për hartimin e draftit janë marrë referenca nga praktikatat më të mira nga vende të ndryshme të Bashkimit Europian. Në vijim po punohet edhe për projekt-akte të tjera që do të rregullojnë procesin e tarifimit të përdorimit të burimeve ujore.

## GJOBITEN AUTORITETET LOKALE—SHKELJE NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE



së fundmi.

Ministri i Mjedisit, më datë 20 Mars 2014, ju dërgoi letër nominale të gjithë të zgjedhurve vendor për të marrë masa për menaxhimin e mbetjeve në territorin e tyre duke ju lënë një afat prej 30 ditësh.

Në letrën drejtuar autoriteteve lokale theksohej se “Kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ” (referuar Ligjit 10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” pikës 12 të nenit 21).

Vendosja e gjobave për kryetarët e Komunave dhe Bashkive ka qënë nga veprimet më të debatueshme

Gjithashtu komunat dhe bashkitë, në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike realizojnë grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave dhe në mbështetje të Ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” gërmën “c” të pikës 3 të nenit 10.

Gjatë kësaj kohe kryetarët e komunave duhet të kishin marrë masat e nevojshme për një komunë më të pastër duke i depozituar mbetjet e banorëve, jo pranë pikave sensitivë siç janë brigjet e lumenjëve apo pranë shtëpive të banimit.

Kontrollet e filluara nga Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, gjatë kontrollit të ushtruar, ka ngarkuar me përgjegjësi të drejtëpërdrejtë drejtuesit e komunave dhe bashkive që nuk kanë marrë asnjë masë për përmirësimin e situ-


atës së depozitimit të mbetjeve në komunat apo bashkitë e tyre, duke i ngarkuar me gjobë në vlerën 500.000 lekë.

Debatet e gjeneruara nga ky proces nuk ndihmojnë, pasi është e pamohueshme fakti që jetojmë në mjedise aspak të pastra dhe padyshim që secili nga Kryetarët e komunave dhe bashkive duhet të mendojë që me ato financa që ka të zgjidhë këtë situatë. Sipas legjislacionit është detyrim i pushtetit vendor të gjejë pikën ku do grumbullojë mbetjet e krijuara dhe do punojë për të hequr në kohën e duhur nga pikat e grumbullimit për të siguruar një mjedis të pastër për banorët e tij.

Ministria e Mjedisit është e vendosur që të vazhdojë procesin e nisur për të përmirësuar situatën në mjediset e komunave dhe bashkive të vendit.

## LEJET MJEDISORE PRILL 2014

| NR | SUBJEKTI                   | AKTIVITETI   | VENDODHJA                   | VENDIMI   |
|----|----------------------------|--|-----------------------------|-----------|
| 1. | ALBANIAN GREEN ENERGY 2797 | HEC  | Lepenicë, Vlorë             | Refuzohet |
| 2. | ALBANIAN GREEN ENERGY 2862 | HEC  | Lepenicë, Vlorë             | Refuzohet |
| 3  | ALBANIAN HIDROPOËER 2013   | Ndertimi I Hec-it ne lumin Mat   | Milot, Laç.                 | Refuzohet |
| 4  | AYEN AS ENERGJI            | Shfrytëzim minerar aluvionesh  | Rrëshen, Lezhë.             | Miratohet |
| 5  | BALKAN GREEN ENERGY 3899   | Rikonstruksion dhe funksionim HEC-i  | Korçë & Elbasan             | Miratohet |
| 6  | BALKAN GREEN ENERGY 2864   | Rikonstruksion dhe funksionim HEC-i  | Dibër                       | Miratohet |
| 7  | BALKAN GREEN ENERGY 2860   | Rikonstruksion dhe funksionim HEC-i  | Borsh, Vlorë                | Miratohet |
| 8  | BALKAN GREEN ENERGY 3005   | Rikonstruksion dhe funksionim HEC-i  | Librazhd, Elbasan           | Miratohet |
| 9  | BALKAN GREEN ENERGY 3006   | Rikonstruksion dhe funksionim HEC-i  | Zapod, Kukës                | Miratohet |
| 10 | BALKAN GREEN ENERGY 3063   | Rikonstruksion dhe funksionim HEC-i  | Korçë                       | Miratohet |
| 11 | BALKAN GREEN ENERGY 2858   | Rikonstruksion dhe funksionim HEC-i  | Kukës                       | Miratohet |
| 12 | ERKILI                     | Linjë për prodhimin e gëlqeres me aspirim  | Krastë, Krujë               | Refuzohet |
| 13 | KRISTI - IV                | Prodhim pije alkolike  | Kamëz , Tiranë              | Miratohet |
| 14 | TREMA ENGINEERING 2 4026   | Kantiere , linje fraksionimit të inerteve dhe impiantit të prodhimit të betonit në funksion të punimeve.   | Petran, Përmet, Gjirokastrë | Miratohet |
| 15 | TREMA ENGINEERING 3 3962   | Ndërtim i sheshit të poshtëm të depozitimit të inerteve, (landfill inertesh) të gjeneruara nga punimet e hapjes se tunelit të derivacionit të Hec -Langarica | Petran, Përmet, Gjirokastrë | Miratohet |
| 16 | TREMA ENGINEERING 4 3944   | Ndërtim i sheshit të sipërm të depozitimit të inerteve, (landfill inertesh) të gjeneruara nga punimet e hapjes se tunelit të derivacionit të Hec -Langarica  | Petran, Përmet, Gjirokastrë | Miratohet |



**THËNIA E MUAJIT**  
 “Nëse kërkon begati për një vit, mbill misër.  
 Nëse kërkon begati për dhjetë vjet, mbill pemë.  
 Nëse kërkon begati për njëqind vjet, eduko njerëzit.” –  
*Proverb Kinez*

**SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT**  
 Email: info@moe.gov.al

**PËR NJË ADMINISTRATË PUBLIKE TË PËRGJEGJSHME DHE PROFESIONALE**

**VIJOJNË TRAJNIMET ME PUSHTETIN VENDOR**



Ministria e Mjedisit vijon trajnimet me përfaqësuesit e pushtetit vendor në të gjithë vendin.

Trajnimet fokusohen në detyrimet ligjore të njëjstëve të pushtetit vendor për çështjet mjedisore. Këto trajnime përbajnë kryesisht tre module kryesore: Procesi i VSM-së, Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve dhe Konventa e Aarhusit.

Nëpërmjet prezantimeve për temat e mësipërme dhe diskutimeve, përfaqësuesit e njëjstëve vendore konsolidojnë njohuritë e tyre për legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe detyrimet përkatëse për të gjitha proceset lokale, që kërkojnë

vlerësim strategjik mjedisor, që e bëjnë të detyrueshme informimin dhe konsultimin e publikut, si edhe problematika e menaxhimit të mbetjeve.

Veçanërisht çështja e menaxhimit të mbetjeve rezultojnë të jetë më interesantja, edhe për shkak të problematikës së saj.

Deri tani janë kryer trajnimet me përfaqësuesit lokalë të Prefekturave të Tiranës, Durrësit, Lezhës, Elbasanit, Fierit, Vlorës, Beratit, Kukësit dhe Gjirokastrës.

Trajnimet do vazhdojnë edhe gjatë muajit të ardhshëm për qarkun e Shkodrës, Korçës dhe Dibrës.



Ministria e Mjedisit ka vijuar punën për trajnimin e stafit të nënpunësve civilë sipas udhëzimeve nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), më qëllim rritjen e profesionalizmit të nënpunësve të saj.

Prej mëse dy muajsh trajnimet janë zhvilluar rregullisht për pesë module të ndryshme: Etika në Administratën Publike, Integrimi Europian i Shqipërisë, Ligji i ri për Nënpunësin Civil, Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimi i Brendshëm Organizativ.

Përgjithësisht këto trajnime janë vlerësuar të vlefshme, duke qenë se i kanë krijuar mundësi stafit të Ministrisë të shkëmbejnë mendime, përvoja dhe njohuri për punën që bëjnë dhe për mënyrat si mund të përmirësohet cilësia e kontributit dhe shërbimit të gjithësecilit, në funksion të



përbushjes së misionit të Ministrisë dhe të mirës publike.